

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në qështjen juridiko-civile të paditësit [redacted] nga fsh. [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson [redacted] avokate nga [redacted] kundër të paditurve [redacted] nga [redacted], [redacted] nga [redacted], [redacted] nga fsh. [redacted] Komuna [redacted] [redacted] në [redacted] nga fsh. [redacted], [redacted] nga fsh. [redacted] [redacted] nga fsh. [redacted] nga [redacted] dhe [redacted] nga [redacted], për çështjen kontestuese vërtetimi i pronësisë, në seancën kryesore të mbajtur me dt.09.11.2017, pa praninë e palëve ndërgjyqëse mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M
(në bazë të pohimit)

I. MIRATOHET, në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [redacted] nga fsh. [redacted] dhe VERTETOHET, se paditësi është pronar i Pk.nr.00245-0 në vendin e quajtur "Provolia-Lepenc" në sip. prej 755m2 dhe Pk.nr.00751-0 në vendin e quajtur "Kamenica te Kroni" me sip. prej 416 m2 ZK.Nikaj, Kaçanik të evidentuar në çertifikatën e pronës me nr. të lëndës 941-14327/2017.

III. DETYROHET Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronësi në Kaçanik që ti bëjë ndryshimet kadastrale sipas këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të paguaj shumën prej 20 €.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 10.05.2017, në gjykatë ka dorzuar padin, kundër të paditurve [redacted] nga [redacted], [redacted] nga [redacted], [redacted] nga fsh. [redacted] Komuna [redacted] [redacted] në [redacted] nga fsh. [redacted], [redacted] nga fsh. [redacted], [redacted] nga fsh. [redacted] nga [redacted] dhe [redacted] nga [redacted], me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë për ngastrat Pk.nr.00245-0 në vendin e quajtur "Provolia-Lepenc" në sip. prej 755m2 dhe Pk.nr.00751-0 në vendin e quajtur "Kamenica te Kroni" me sip. prej 416 m2 ZK.Nikaj, Kaçanik të evidentuar në çertifikatën e pronës me nr. të lëndës 941-14327/2017.

Ka shtuar se këtë pasuri në vazhdimësi e ka pasur në shfrytëzim dhe posedim duke ushtruar pushtetin faktik pa ndërprerë si pronar i ngastrave të lartcekura pa penguar nga askush por as nga të paditurit, mbi këto baza i ka propozuar gjykatës që ta miratojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar

torizin

banim
ë, Fer
exhme
rr. "Fa

i padi
dhe l
nedin
lesim
ashki
89 n

it.
191 e
214

i lënë
ila pë

ento
oret
kry

Gjykata me datën 30.06.2017, e nxjerr aktvendimin me të cilin i ka detyruar të paditurit që të paraqesin përgjegje në padi, të paditurit me datën 06.07.2017 e kanë pranuar padin me prova. Të paditurit pasë pranimin të padisë me prova në afatin e paraprë ligjorë kanë ushtruar përgjegje në padi, me të cilën i kanë propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadin e paditsit, sepse paditësi këtë pronë e ka në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar.

Po shtu i kanë propozuar gjykatës që të veprojnë konform neni 398 të Ligjit të procedurës kontestimore dhe të merr aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore, po ashtu e kanë njoftuar gjykatën se heqin dorë nga drejta e ankesës, andaj duke marrë për bazë këto fakt të theksuara i ka propozuar gjykatës që të nxjerr aktgjykimi në bazë të pohimit, për shkak se nuk e kundërshtojnë në asnjë pikë kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar

Gjykata pas dëgjimit të palëve e për ta vëretuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje kontestimore juridiko-civile, bëri administrimin e provave të shkruara duke bërë leximin e këtyre provave: Çertifikatën Pronësore me nr. të lëndës 941-14327-2017 si dhe përgjegjet në padi, pa pyetje dhe pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të provave në tërësi dhe të secilës veq e veq, e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile konstatoi këtë gjendje faktike:

Gjykata konstatoi se paditësi është pronarë i paluajtshmërive edhe atë Pk.nr.00245-0 në vendin e quajtur "Provolia-Lepenc" në sip. prej 755m² dhe Pk.nr.00751-0 në vendin e quajtur "Kamenica te Kroni" me sip. prej 416 m² ZK.Nikaj, Kaçanik të evidentuar në çertifikatën e pronës me nr. të lëndës 941-14327/2017, sepse në këto ngasta e ka fituar të drejtën e pronsisë me mbajtje me mirëbesim.

Meqenëse palët nuk e kontestojnë këtë fakt dhe të gjithë të paditurit nuk e kanë kontestuar kërkesëpadin dhe i kanë propozuar gjykatës që të nxjerrë aktgjykimi në bazë të pohimit gjykata duke vepruar konform nenit 148 lidhur me Nenin 160.6 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është i formës së prerë që nga data 09.11.2017, sepse pala e paditur ka hequr dorë nga drejta e ankesës.

Gjykata e detyroi palë paditëse që të paguaj shumën prej 20 € në emër të taksës për padi sepse pala paditëse nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të padisë si dhe konform udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe konform nenit 253.5 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK
C.nr.93/17, i dt.09.11.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS

Gjyqtari:
Riza Livoreka

09. 11. 17

GJYKATA THEMELORE
SNOVNI SUD U

Marrësi: 6/11/17
Prima

3. NEX+

1. Pasi marrësi në dorëzimi u bë duke marrësit - kujdestar në punë në të njëjtë
2. Pasi marrësi e shkresës, shkresa e ngjitur në derën e t
1. Posto primilac ti, dostava je data zgrade, susedu lic
2. Posto primilac je dostavljeno u st stana odnosno pro

Më _____
dana _____
Shkaku i refuzimit, _____
razlog odbijanja _____

paguesit
me i prezime platiše
Nr. i letërnjoftimit/A
broj lične karte/Adr
Emri i arkëtarit në b
me blagajnika u bar

Të rejtje: Paguesi duhet të bë
shfrytësim. Për Organizata

Vapomena : uplata mora bi
ovratok rok od vaučera za